



KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

## Shpallje Publike

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, Seksionin V Pikën 3 (c) të Rregullores së KEK-ut Sh.a dhe nevojave të paraqitura për plotësimin e vendit të lirë të punës në Zyrën për Siguri Industriale & MKZ- Drejtorin e Operimeve , Divizioni i Burimeve Njerëzore, më 18.06.2018 publikon ofertën për pozitën e mëposhtme:

### Administrator për menaxhimin e të dhënave statistikore (1 kryerës)

#### Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

- Bartësi i punës është përgjegjës për menaxhimin dhe evidentimin e rasteve të aksidenteve dhe incidenteve në KEK dhe analizimin e tyre sipas instruksioneve të Menaxherit të SI & MKZ dhe specialistëve për SI & MKZ të KEK-ut..
- I kërkon raportet nga sektorët e Sigurisë nëpër Divizione gjegjësisht nga udhëheqësit e sektorëve apo personave që ata i autorizojnë e në bazë të instruksioneve të Menaxherit të Zyrës për SI & MKZ dhe specialistit për SI & MKZ të KEK-ut.
- I identifikon dhe evidenton në librin kryesor shkaktarët e aksidenteve dhe incidenteve dhe shkaktarët potencial të zjarrit.
- Evidenton dhe analizon pjesët e lënduara të trupit sipas standardeve të aprovuara në KEK
- Evidenton dhe analizon shkaqet e lëndimit gjegjësisht burimin e lëndimit të punëtorëve
- Evidenton dhe analizon pjesët e reparteve të departamenteve për të lënduarit
- Në mënyrë tabelore paraqet lëndimet e raportueshme dhe lëndimet që krijojnë shpenzime.
- Paraqet në mënyrë grafike apo me diagrame lëndimet sipas instruksionit të Menaxherit për SI & MKZ dhe specialistit për SI & MKZ të KEK-ut.
- E bënë paraqitjen në Power Point të prezantimeve për trajnime dhe seminare.
- Kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së Menaxherit për SI & MKZ dhe specialistit për SI & MKZ të KEK-ut.
- Është përgjegjës për mbajtjen e evidencës dhe saktësinë e numrit të lëndimeve në KEK – Librin Kryesor të lënduarve të raportueshme.
- Është përgjegjës për konfidencialitetin e të dhënave
- Administratori i menaxhimit të analizave dhe statistikave për punën e vet i raporton Menaxherit për SI & MKZ dhe specialistit për SI & MKZ të KEK-ut.

#### Autorizimet:

Vepron sipas autorizimeve të dalura nga rregulloret për SI & MKZ dhe Menaxherit të SI & MKZ

#### Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:

Përgatitja e mesme profesionale. Të ketë aftësi pune në ekip, të punoj me kompjuter me sistemin e Wordit, Excel dhe Power Point.

### Divizioni i Burimeve Njerëzore, fton të gjithë të interesuarit të aplikojnë për pozitat e publikuara

Për hollësitë e mëtutjeshme për pozitën e lartpërmendur shikoni në faqen e internetit të KEK-ut [www.kek-energy.com](http://www.kek-energy.com). Aplikacionet mund të merren në faqen tonë të internetit [www.kek-energy.com](http://www.kek-energy.com) dhe së bashku me CV në formë elektronike të dërgohen në adresë [ofertapune@kek-energy.com](mailto:ofertapune@kek-energy.com) , pranë divizionit të Burimeve Njerëzore në KEK.

Kontrata e punës për punëmarrësit që do të zgjedhën për plotësimin e pozitave të shpallura do të jetë 1 vjeçare me mundësi vazhdimi, puna provuese 3 muaj.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të pranohen ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen

Prishtinë, 18.06.2018

Data e aplikimit deri më 02.07.2018 ora 16.00



Divizioni i Burimeve Njerëzore